



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 71

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 22 Maj 2013, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca e Liburn Aliu.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 7.5.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e organeve ;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 7.5.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e datës 07.05.2013

3. Shqyrtimi i Projektligjit për transplantimin e organeve

Fikrim Damka - Tha se kemi marr një letër me disa komente nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, për Projektligjin për transplantimin e organeve. E hapi diskutimin.

Time Kadrijaj - Tha se ne si Komision, kemi punuar shumë për të bërë një ligj të zbatueshëm në praktikë, andaj edhe vazhdimisht gjatë procedurës së amendamentimit, kemi kërkuar që edhe përfaqësuesit e EULEX-it të jenë bashkëpunues me vërejtjet dhe me komentet e tyre konkrete.

Flora Borvina - Tha se këto vërejtje që marrim nga Zyra e BE-së në Kosovë, nuk kemi ndonjë konkretizim të çështjes, ndoshta sepse ata nuk i janë përgjigjur ftesës tonë për pjesëmarrje në grup punues. Konsideroj se kjo shpresë ka shumë paragjykime, së pari sepse thotë se kjo fushë duhet të rregullohet në mënyrë të matur dhe delikate dhe së dyti, sektori privat nuk duhet të përfshihet këtu, atëherë pse e kanë lejuar sektorin privat dhe publik të barazohen me Ligjin për Shëndetësinë?

Masa tjetër sugjестive është se ata kërkojnë që ne të kemi organ të përbashkët, ndërsa ne kemi si masë sigurie Bankën Qendrore të organeve, ku sektori shtetëror e kontrollon sektorin privat.

Nëse është nevoja, ne do t'i ftojmë dhe do t'ju tregojmë se të gjitha këto propozime janë marrë parasysh dhe se ky sugjerim si i tillë, nuk ka kuptim.

Nazane Breca - Tha se këto sugjerime, ne i kemi inkorporuar, mirëpo, nuk është ndonjë problem nëse projektligji shtyhet edhe disa ditë, sepse e rëndësishme është të del një Ligj i mirë dhe i zbatueshëm.

Salihe Mustafa - Tha se duhet ta shqyrtojmë edhe një herë në grup punues këtë projektligj dhe këto komente që kanë ardhur.

Gëzim Kelmendi - Tha se kërkesa e Zyrës së BE-së në Kosovë, që të mos lejojmë transplantimin e organeve në sektorin privat, është një kërkesë me vend, duke marrë parasysh përvojën e hidhur që kemi në të kaluarën me këtë dukuri.

Kosova ka mungesë të kapaciteteve të inspektorateve, dhe si pasoj nuk po bëhet mbikëqyrja e mirë ndaj këtyre institucioneve.

Në anën tjetër, u përmend që Ligji për Shëndetësinë e barazon sektorin privat dhe publik, por askund nuk e ndalon ose lejon transplantimin e organeve në sektorin privat.

Bahri Thaçi - Tha se përfaqësuesi i BE-së në Kosovë, sigurisht ka menduar që Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme për ta kontrolluar sektorin privat, por në anën tjetër, me Ligjin për shëndetësinë, sektori privat dhe publik janë të barabartë, prandaj, jam për forcimin e mbikëqyrjes, sepse kështu siç e kemi sot shëndetësinë në Kosovë, jam i sigurt që më parë do të

krijohen kushtet për transplantim në institucionet private se sa në ato publike, edhe për nga infrastruktura por edhe për nga ana e ekspertëve.

Ministria është ajo që e jep licencën dhe po ajo, duhet të zhvillojë mbikëqyrje të vazhdueshme mbi këto institucione.

Liburn Aliu - Tha se nëse çështjen e transplantimit të organeve e lejojmë në sektorin privat, atëherë do të ketë hapësirë për manipulime. Andaj, pajtohem plotësisht se transplantimi i organeve të lejohet vetëm në sektorin publik.

Time Kadrijaj - Tha se ky Projektligj ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë, dhe ne nuk kemi bërë ndryshime në atë, se cili sektor ka të drejt të bëjë transplantim, por vet Projektligji që ka ardhur, ka lejuar transplantimin edhe në sektorin privat.

Salihe Mustafa - Tha se Projektligjet të gjitha vinë të tilla, por ne jemi ata, të cilët vendosim se si do të jetë përfundimi i tyre.

Fikrim Damka - Tha se kjo çështje pak është neglizhuar nga institucionet ndërkombëtare, por nuk jemi vonë dhe kemi kohë edhe për ndryshime.

Nazane Breca - Tha se janë dy çështje të rëndësishme që rregullohen me këtë Projektligj, këtë banka e organeve dhe transplantimi i organeve. Bankën e organeve, ne e kemi lënë në institucione publike bashkë me listat e pritjes, të cilat janë në mbikëqyrje të drejtpërdrejt të Qeverisë, ndërsa procedura mund të kryhet edhe në sektorin privat, e edhe në sektorin publik. Unë që nga fillimi nuk jam pajtuar që të mbetet transplantimi në institucione private, por pasi Ligji i Shëndetësisë e barazon sektorin publik dhe privat atëherë, çështja mund të shkojë prapë në Gjykatën Kushtetuese.

Gezim Kelmendi - Tha se faktin që ekziston Banka e organeve, nuk do të thotë që në të ardhmen nuk mund të bëhen keqpërdorime në sektorin privat, sepse, nëse një institucion privat bënë brenda një viti 10 (dhjetë) transplante të organeve përmes Bankës dhe procedurave të rregullta, kush do të sigurojë që edhe 20 të tjera nuk do t'i bëjë në mënyrë ilegale. E mira e këtyre vërejtjeve është se e përforcojnë sektorin publik.

4. Të ndryshme.

Në piken të ndryshme Komisioni formoi grupin punues për amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Grupi punues do të udhëheqet nga deputeti Liburn Aliu, ndërsa pjesë e grupit do të jenë deputetët : Flora Brovina, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi dhe Salihe Mustafa.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka